



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
P-08
Prishtinë, më 19 janar 2015, ora 10:00

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 19 JANAR 2015**

Seancën e kryesoi Kadri VESELI, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi Xhavit HALITI, nënkryetar.

Kryetari konstatoi se në sallë janë të pranishëm 99 deputetë dhe i hapi punimet e Sesionit pranveror të Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2015.

Ai i njoftoi deputetët se rendi i ditës për seancën e sotme është përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 14 janar 2015, me këtë pikë - Shqyrtimi i parë Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike.

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike.

Kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa, tha se Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike është përgatitur për një kohë të gjatë. Ka qenë pjesë e aktivitetit kuvendor në mandatin e kaluar dhe po ashtu e kemi paraparë që të jetë pjesë edhe e këtij mandati.

Në ndërkohë, ne jemi ballafaquar me një problem të veçantë sa i përket të ardhmes së “Trepçës” dhe objektivi ynë themelor si Qeveri e Republikës së Kosovës është që të krijojmë kushte për riorganizimin e “Trepçës”, në mënyrë që ajo të punojë pa asnjë problem ligjor në të ardhmen.

Qëllimi themelor po ashtu është që të pamundësojë procedurën e falimentimit të “Trepçës”, sepse konsiderojmë se kjo nuk është në interes të punëtorëve të “Trepçës”, nuk është në interes të qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe nuk është në interes të askujt.

Ai tha se ne i kemi ndërmarrë të gjitha masat si Qeveri që t’jua propozojmë juve mënyrën më adekuate që në këtë moment ta parandalojmë aktivizimin e procedurës së falimentimit të “Trepçës”, ndërkaq, në ndërkohë, t’i marrim të gjitha masat që bashkërisht të vendosim se si do ta organizojmë “Trepçën” në të ardhmen.

Ne vetë kemi kërkuar nga Kuvendi dhe nga Kryesia e Kuvendit që kjo çështje të vihet në rend dite. Në ndërkohë kemi konstatuar se janë shumë elemente të cilat kërkojnë që ne t’i shqyrtojmë, sidomos ato që kanë të bëjnë me obligimet, përkatësisht me detyrimet kreditore të kombinatit “Trepça”, e të cilat, sipas disa informatave mund të sillen deri 1,4 miliard euro, dhe për të cilat ne duhet të vendosim pas një analize më të qartë se si të adresohen ato detyrime kreditore.

Prandaj, kjo është arsyeja themelore që ne kërkojmë që në këtë seancë të mos shqyrtohet kjo pikë e rendit të ditës, që ne si Qeveri ta shqyrtojmë edhe një herë sot gjatë ditës këtë projektligj, ta sjellim në Kuvend dhe që nesër Kuvendi i Republikës së Kosovës mund ta trajtojë edhe këtë projektligj me propozimin, përkatësisht riadresimin që ne do t’ia bëjmë Kuvendit.

Ndërkaq, propozojmë që sot, më 19 janar 2015, në orën 14:00, të mbahet një seancë e jashtëzakonshme e Kuvendit, në përputhje me nenin 69, paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që ta shqyrtojmë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 04/L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre, me të cilën ne mendojmë se mund t’i plotësojmë kushtet, në mënyrë që të mos mund të aktivizohen procedurat e falimentimit të Kombinatit “Trepça”.

Kryetari konstatoi se Qeveria e Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 56.5 të Rregullres së Kuvendit, e tërhoqi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike.

Kryetari i mbylli punimet e seancës së sotme në orën 11:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale